

POLITIKAT E GJUHËS DHE VARIACIONI GJUHËSOR NË SHQIPËRINË PAS-SOCIALISTE DHE KOSOVËN E PAVARUR

Ky projekt disavjeçar zhvillohet si temë doktrale dhe mbështetet nga Fulbright Hays, American Councils Title VIII, Universiteti i Michiganit, Departamenti i Antropologjisë dhe Departamenti i Gjuhësisë, si dhe Instituti i Antropologjisë Kulturore e Studimit të Artit në Tiranë.

Një nga çështjet kryesore që shtron ështëse çfarë tregon zëri për një terren politiko-ekonomik në ndryshim e sipër? Raportet midis standartizimit të gjuhës dhe variacionit sociolinguistik janë studiuar më shpesh në kontekstin e zhvillimit të kapitalizmit industrial dhe pabarazitë që ai sjell në metropolet e botës së parë dhe në kolonitë e botës së tretë. Më pak të studiuar janë gjuhët kombëtare të standardizuara si pjesë e modernizimit socialist dhe që vetëm më vonë u bënë pjesë e tregut neoliberal capitalist, shpesh paralelisht me ndryshime kufitare e administrative. Pavarësisht eksperiencave të ndryshme me socializmin shtetëror dhe bazave dialektore të ndryshme, Shqipëria dhe Kosova kanë një gjuhë standarde të përbashkët falë nacionalizmit gjuhësor pas-osman. Teoritë e raporteve midis gjuhës dhe pushtetit thonë që gjuhët standarde janë hegjemonike në tregun kapitalist.

Megjithatë që nga rënia e socializmit shtetëror në Shqipëri dhe në Kosovë, dialekti ‘jo-standard’ geg ka marrë një prestigj të ri në një komunitet shqiptar gjithnjë e më transnacional. Ky studim historik, etnografik, dhe sociolinguistik studion mënyrat në të cilat një gjuhë e standardizuar në lidhje me vlera anti-kapitaliste dhe anti-koloniale në kushtet e socializmit shtetëror ndikon në praktikën e dëgjimit, të folurit, dhe të vlerësimit të gjuhës në grupe të ndryshme në Shqipëri dhe në Kosovë.

Hulumtimet paraprake e këtij studimit tregojnë që për shkak të ndryshimeve sociale e politike që lindën pas rënies së socializmit shtetëror, përkatësia e brezit ndikon në ideologjitë dhe praktikën gjuhësore të shqiptarëve. Studimet e mëparshme janë përqendruar më shumë tek ndryshimet dialektore dhe politikat e planifikimi gjuhësor (p.sh. Byron 1976; Gjinari dhe Shkurtaç 2003; Munishi 2013). Këto studime kanë sjellë përshkrime të rëndësishme të varieteteve të gjuhës shqipe, por nuk kanë analizuar mjaftueshëm proceset shoqërore që i krijojnë. Gjithashtu pak prej tyre kanë analizuar gjuhën e folur me anë të inçizimeve. Studimet e fundit sociolinguistike kanë mëtuar që kufijtë midis varianteve të ndryshme të gjuhës ndikohen nga ndërgjegjia gjuhësore dhe aftësitë gjuhësore të përfutuara përmes ndërveprimeve shoqërore (Irvine dhe Gal 2000; Babel 2014; 2016). Dëgjimi i përsëritur i inçizimeve, analizat e imta akustike dhe vlerësimet e gjuhës së folur nga ana e pjesëmarrësve vazhdimisht dëshmojnë për larminë e praktikave të dëgjimit, të folurit dhe të vlerësimit edhe në komunitetet gjuhësore më homogjene.

Në bazë të studimeve të mëparshme dhe të atyre paraprake, ky projekt studimor hulumton ekonominë politike të folurit dhe të dëgjuarit gegnishten, toskërishten, dhe shqipen standarde në Shqipërinë pas-socialiste dhe Kosovën e pavarur. Duke aplikuar metoda etnografike, sociolinguistike, dhe arkivore, studimi synon t’i përgjigjet tre pyetjeve: (1) Si ndikon zhvillimi i gjuhës standarde nëpërmjet ideologjiive të socializmeve shtetërore përkatëse në hierarkitë dhe në pabarazitë e sotshme gjuhësore? (2) Cilat janë praktikën e folurit dhe e dëgjuarit që frymëzojnë idetë bashkëkohore mbi diferencimin dhe njësimin gjuhësor midis shqipfolësve? (3) Çfarë efekti ka përkatësia e brezit në folurit, të dëgjuarit, dhe vlerësimin e gjuhës standarde dhe të dialekteve?

Sfondi studimor

Në linjë me prirjen e përgjithsme për analizë kulturore të shkëputur nga ekonomia politike në studimet mbi Evropën Juglindore (Ballinger 1999), historia e standardizimit të gjuhëve në rajon zakonisht analizohet në lidhje me nacionalizmin romantik (p.sh. Friedman 1999; Greenberg 2004). Rasti i shqipes nuk përbën ndryshim. Në periudhën e shpërbërjes graduale të perandorisë osmane, gjuha luajti një rol të rëndësishëm në bashkimin e shqipfolësve me përkatësi të ndryshme fetare (Skendi 1967; Friedman 2005). Gjuhës së përbashkët i ishte dhënë detyra të bashkonte komunitete shqipfolëse që ndaheshin nga kufijtë e ri shtetërorë. Kjo që sidomos e rëndësishme për ato komunitetet në trevat veriore që u bënë pjesë e Jugosllavisë. Këto komunitete përdornin varietete të ndryshme të dialekteve gege dhe toske me shkallë të ndryshme të kuptimshmërisë midis tyre. Duke përceptuar këto diferenca gjuhësore si pengesë për bashkimin kombëtar, intelektualët e Rilindjes bënë përpjekjet e para për të njëzuar gjuhën shqipe. Edhe pse politikat kombëtariste nxitën njësimin e gjuhës si projekt kulturor, ky projekt ekzistonte brenda një sistemi ekonomik. Ky studim kërkimor merr si të mirëqenë që standardizimi i gjuhës ka pasoja politiko-ekonomike (Irvine 1989; Fridrich 1989) dhe eksploron se cilat ishin ato në rastin e diktaturës socialiste në Shqipëri dhe Kosovën Jugosllave.

Studimet mbi ekonomine politike të gjuhës janë fokusuar tek mënyrat se si standardizimi i gjuhës bën pjesë në imponimin kapitalist drejt homogenizimit (si p.sh. te paraja, prodhimi, pesha etj.) që i shërben menaxhimit racional dhe efikas të shoqërisë (Milroy 2001; Inoue 2006). Përmes arsimit shtetëror, gjuha standarde natyralizohet dhe lidhet me suksesin në tregun e punës, duke kontribuar në pabarazinë socioekonomike (Bourdieu 1991). Edhe pse disa studime kane aplikuar këto teori jashtë kontekstit të ardhjes së kapitalizmit industrial në Evropën Perëndimore (p.sh. Haeri 1997; Inoue 2002), janë të pakta studimet mbi raste të ngjashme me Shqipërinë dhe me Kosovën ku krijimi i një gjuhe standarde ishte pjesë e socializmit shtetëror. Në Shqipëri, qeveria socialiste drejtohej më së shumti nga toskfolësit të cilat vendosën për një gjuhë standarde me bazë toskërishten ndërkohë që filluan të hiqnin gegërishten nga sferat publike (Vehbiu 1997). Edhe pse toskërishtja nuk flitet në Kosovë, udhëheqësit shqiptarë atje kanë vendosur për të njëjtën gjuhë standarde si reagim kundër politikës jugoslave që nxiste shqiptarët e Kosovës të zhvillonin një identitet

ndryshe nga ai i shqiptarëve të Shqipërisë (Ismajli 2005). Këto projekte për një gjuhë standarde zyrtarisht bazoheshin në vlerat socialiste të emancipimit klasor dhe të antikolonializmit. Kjo temë doktorature shtron pyetjen se çfarë pabarazish krijon kuptimi modernist i gjuhës standarde si një formë racionale dhe efikase e komunikimit kur zhvillohet në socializmin shtetëror dhe më vonë hyn në tregun kapitalist në formën e tij neolibérale e jo industriale.

Që nga vitet 90-të, kontaktet gjuhësore midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës janë bërë më të shpeshta falë ndryshimeve në politikë, në infrastrukturë dhe në zhvillimin e mediave të reja. Disa studime tregojnë prirje për afrim midis gegërishtes dhe toskërishtes në të folurat e njerëzve me shkollë të lartë (Moosmüller dhe Granser 2006) bashkë me një tendencë për të lidhur shqipen standarde me Shqipërinë e Mesme, një zonë historikisht gegfolëse (Morgan 2017). Për më tepër, disa gegfolës pohojnë që shqipja standarde nuk është veçse një imponim i sistemit totalitar komunist. Prandaj në momentin që shqipja standarde hynte në tregun kapitalist ku teoritë do të parashikonin se do të bëhej edhe më hegjemonike, gegërishtja, dialekti ‘jo-standard’, filloi të përhapej më shumë dhe në mënyra të reja, sidomos midis shqiptarëve me eksperiencë praktike me dialekte të ndryshme.

Pavarësisht nga këto prirje centripetale, profesionistët gjuhësorë dhe intelektualët publikë në Shqipëri dhe në Kosovë shpesh shprehin shqetësim për prirje gjuhësore centrifugale dhe humbjen e statusit të shqipes standarde (p.sh. Vehbiu 1997; QSA 2011). Në këto diskurse, përhapja e gegërishtes në disa regjistra publikë është shqetësuese për arsye se nuk është e institucionalizuar. Ky studim analizon këtë mospërputhje midis praktikave dhe perceptimeve popullore dhe atyre profesionale, duke krahasuar diskurse mbi diferencat dhe ngjashmëritë gjuhësore me praktikat konkrete të të folurit dhe të të dëgjuarit në grupe të ndryshme shoqërore.

Studimet gjuhësore për shqipen janë fokusuar më shumë te variacioni gjeografik në gjuhë dhe analizat e teksteve. Më pak vëmendje u është përkuftuar praktikave të të folurit dhe të të dëgjuarit në gjuhën standarde midis grupeve me përkatësi të ndryshme brezash dhe me eksperiencë të ndryshme politiko-ekonomike. Antropologët e gjuhës kanë argumentuar që e folura e njeriut gjithmonë nënkupton një zgjedhje midis zërave me vlera të

ndryshme morale që vetë ftojnë gjykime shoqërore (Hill 1995; Keane 2011). Në Tiranë, zërat gegë mund të përceptohen si ‘të trashë’ dhe si rezultat të vlerësohen si të paarsimuar e të prapmbetur ose si shenjë pluralizmi antikomunist. Kjo mund të ndikojë edhe tek përfshirje sociale dhe tek aksesit tek të mirat sociale. Një pyetje e hapur empirike është te cilat veçori gjuhësore kanë vëmendjen përdoruesit e shqipes kur prodhojnë e përceptojnë këto zëra të ndryshëm në shqip. Kjo gjithashtu ngre pyetje të tjera teorike në lidhje me korelatat fonetike të zërit (Kreiman dhe Sidtis 2011) dhe ndërgjegjen e aftësitë sociolinguistike (Babel 2016). Studimet e mia paraprake tregojnë që variacioni në bashkëtingullorët (p.sh. shkrirja /rr/-/r/), zanoret (sidomos tek zanorja e ulët e mesit /a/), dhe ton (F0) është i rëndësishëm për shumë shqipfolës. Studimet e tjera thonë që ky variacion kushtëzohet nga një sërë faktorësh socialë dhe gjuhësorë (p.sh. Dodi 1970; Ismajli 1987; Moosmüller dhe Granser 2006). Me anë të një analize sistematike të gjuhës së folur, studimi parashikon të gjejë prova që disa veçori gjuhësore zakonisht të quajtura geqe janë të pranuar dhe bile të preferuara në regjistra standarde, sidomos për disa shqipfolës të ri në moshë.

Edhe pse mosha është po aq dinamike sa kategori të tjera sociale si gjinia dhe raca, brezi është një dimension i variacionit sociolinguistik që shpesh merret si i mirëqenë (Suslak 2009). Studimet sociolinguistike kanë aplikuar shumë metodën e *apparent time*² (Sankoff 2006) për të teorizuar ndryshimin gjuhësor pa analizuar kuptimet që mbart koncepti i brezit për pjesëmarrësit në studim. Këto kuptimet ndikojnë në ideologjitë dhe praktikatat gjuhësore sepse lidhen me diferenca në mundësi dhe aspirata ekonomike (Meek 2009). Për shkak të ndryshimeve politike pas-socialiste, ka ndryshime të konsiderueshme midis brezave në Shqipëri e Kosovë për sa i përket eksperiencave politiko-ekonomike. Studimet e mia paraprake tregojnë që këto ndryshime ndikojnë në praktikatat gjuhësore. Për shembull, të rinjtë nga zonat ku flitet dialekti tosk njohin dhe përdorin disa veçori geqe më shumë se prindërit e tyre falë eksperiencës me dialektin geg të Tiranës

² Në studimet *apparent time*, diferenca midis brezave në të folur merren si ndryshime gjuhësore në komunitet. Por, këto diferenca mund të jenë gjithashtu rezultat i normave të ndryshme gjuhësore për brezat e ndryshëm.

dhe mediave që vijnë nga Kosova. Në Kosovë, ka një brez të vjetër të aktivistëve që flasin një gjuhë standarde që nuk dallohet nga ajo që flasin në shqipërinë veriore ndërkohë që rinia në Kosovë më shpesh flet një gjuhë standarde që ka veçori të veçanta për Kosovën. Ky studim do të testojë këto hipoteza me anë të intervistave me folësit nga breza të ndryshëm bashkë me një analizë shoqërore të brezit.

Plani kërkimor

Zbatimi i këtij projekti kërkimor do të kryhet përmes tre metodave: pjesëmarrje me vëzhgim, inçizime sociolinguistike dhe punë në arkiv. Marrë së bashku këto tre metoda më lejojnë që përgjigjet e pyetjeve të mia kërkimore të kenë ngjyrimë historike dhe kontekstuale.

Pjesëmarrje me vëzhgim

Kjo metodë është e rëndësishme për të analizuar normat e nënkuptuara që strukturojnë jetën e përditshme (Blommaert dhe Dong 2010). Në Tiranë dhe në Prishtinë, do të kërkoj leje që të marr pjesë në aktivitete të ndryshme shoqërore dhe institucionale (p.sh. mësimet e gjuhës, dreka miqësore dhe familjare etj.) ku mund të bëj vëzhgime. Në këto aktivitete, do të fokusohem tek mënyrat sesi pritshmëritë kulturore dhe rënditja ndërveprimore midis pjesëmarrësve i japin interpretim aktit të komunikimit (Gumperz dhe Hymes 1972; Goffman 1981). Do të fokusohem tek gjetja e variacionit në përdorimin dhe vlerësimin e veçorive gjuhësore në kontekste të ndryshme (p.sh. në mësim ose në kafe) dhe në modalitete të ndryshme (p.sh. komunikim ballë për ballë, mesazhe zanore, shkrime në platforma të ndryshëm). Me anë të shënimeve, do të shtroj dhe të testoj hipoteza të vogla në lidhje me pyetjet e mëdha kërkimore. Vëzhgimet do të informojnë se ku, kur, dhe si të vazhdoj më inçizimet sociolinguistike.

Inçizime sociolinguistike

Këto metoda do të më mundësojnë analizën e diskursit, analizën fonetike, dhe analizën statistikore të normave gjuhësore dhe gjithashtu do të më lejojnë të informohem për interpretimet e këtyre normave nga ana e pjesëmarrësve. Do të mbledh tre lloj inçizimesh: intervista me profesionistët

e gjuhës, intervistat sociolinguistike me pesë prindër dhe fëmijët e tyre, dhe biseda joformale midis këtyre prindërve dhe fëmijëve të tyre. Intervistat do të inçizohen me mikrofoni në mënyrë që inçizimi të jetë i përshtatshëm për analizë akustike. Bisedat joformale do të inçizohen pa mikrofona që të krijojnë një ambient më të rehatshëm për të folur lirshëm. Përveç pyetjeve që do t’ju shtroj, do t’u luaj pjesëmarrësve në intervistë/bisedë inçizime të ndryshme në mënyrë që ata të shpjegojnë perceptimin e tyre mbi zërin në lidhje me informacionet shoqërore që mbart.

Punë në arkiv

Me anë të punës në arkiv, synoj të lidh praktikën e perceptimit gjuhësor bashkohor me përfundimin e tyre historik. Diçka shkencore e një periudhe siç ishte socializmi shtetëror në Shqipëri dhe në Kosovë vazhdon të ndikojë në normat e perceptimit dhe të interpretimit edhe pasi rendi politiko-ekonomik ka ndryshuar. Në arkiv, do të analizoj mënyrat dhe kriteret e ndarjeve të hapësirës gjeografike, shoqërore dhe gjuhësore që janë bërë nga ana e studiuesve për të analizuar ndikimin e tyre në praktikën gjuhësore sot.

Përmbyllja

Fakti ‘total’ gjuhësor (Silverstein 1985) na detyron të shohim gjuhën jo si një formë e shkëputur nga raportet shoqërore e politike, por si një mishërim i tyre. Zhvillimi i shqipes standarde në kushtet e socializmit shtetëror dhe pasojat e këtij procesi në praktikën e të folurit dhe të dëgjuarit edhe në demokraci janë fokusi i këtij projekti studimor, i cili ndjek variacionet dhe ndryshimet në kohë dhe në hapësirë të gjuhës shqipe për të kuptuar se çfarë ideologjish politike dhe shoqërore i nënkuptojnë.

Bibliografi

- Babel, Anna M. 2014. Stereotypes vs. Experience: Indexing regional identity in Bolivian Valley Spanish. *Journal of Sociolinguistics*, 18: 5, 604-633.
- Babel, Anna M. 2016. *Awareness and Control in Sociolinguistic Research*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Ballinger, Pamela. 1999. “Definitional Dilemmas: Southeastern Europe as a ‘Culture Area’?” *Balkanologie*, 3:2, 1-15.

- Bloomaert, Jan dhe Jie Dong. 2010. *Ethnographic Fieldwork: A Beginner's guide*. Buffalo, NY: Multilingual Matters.
- Bourdieu, Pierre. 1991. *Language and Symbolic Power*. Harvard University Press: Cambridge.
- Byron. Janet. 1976. *Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian*. The Hague: Mouton & Co.
- Dodi, Anastas. 1970. *Fonetika e Gjuhës Shqipe*. Tirana: Akademia e Shkencave e Shqiperisë.
- Friedman, Victor. 1999. "Linguistic Emblems and Emblematic Languages: On Language as Flag in the Balkans". *Kenneth E. Naylor Memorial Lecture Series in South Slavic Linguistics*. Department of Slavic and East European Languages and Literatures, Ohio State University: Columbus.
- Friedman, Victor. 2005. Albanian in the Balkan Linguistic League: A Reconsideration of Theoretical Implications. *Studia Albanica*, 1, 33-43.
- Friedrich, Paul. 1989. Language, Ideology, and Political Economy. *American Anthropologist*, 28, 295-312.
- Gjinari, Jorgji dhe Gjovalin Shkurtaj. 2003. *Dialektologjia*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Goffman, Erving. 1981. *Forms of Talk*. Philadelphia: U. Pennsylvania Press.
- Greenberg, Robert D. 2004. Language and identity in the Balkans. Oxford: Oxford University Press.
- Gumperz, John J. dhe Dell H. Hymes. 1972. *Directions in Sociolinguistics*. New York: Holt, Rinehart dhe Winston.
- Haeri, Niloufar. 1996. *The Sociolinguistic Market of Cairo: Gender, Class, and Education*. Routledge: London.
- Hill, Jane H. 1995. "Voices of Don Gabriel: Responsibility and Self in a Modern Mexicano Narrative." Në *The Dialogic Emergence of Culture* përgatitur nga Dennis Tedlock dhe Bruce Mannheim: 97-147. University of Illinois Press.
- Inoue, Miyako. 2002. Gender, Language, and Modernity: Toward an Effective History of Japanese Women's Language. *American Ethnologist*, 29:2, 392-422.
- Inoue, Miyako. 2006. "Standardization." Në *Encyclopedia of Languages and Linguistics*, botimi i dytë: 121-127. Elsevier: Cambridge.

- Irvine, Judith T. 1989. "When talk isn't cheap: language and political economy". *American Ethnologist*, 16:2, 248-267.
- Irvine, Judith dhe Gal, Susan. 2000. "Ideology and Linguistic Differentiation. Në *Regimes of Language* përgatitur nga Paul V. Kroskrity: 35-84. Sante Fe, New Mexico: School of American Research Press.
- Ismajli, Rexhep. 1987. "Fonemat Margjinale". Në *Artikuj mbi Gjuhën Shqipe*: 212-218. Rilindja: Prishtina.
- Ismajli, Rexhep. 2005. *Gjuhë Standarde dhe Histori Identitetësh*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Keane, Webb. 2011. "Indexing Voice: A Morality Tale." *Journal of Linguistic Anthropology*, 21:2, 166-178.
- Kreiman, Jody dhe Diana Sidtis. 2011. *Foundations of Voice Studies*. Wiley-Blackwell Publishing.
- Meek, Barbra. 2009. "Respecting the Language of Elders: Ideological Shift and Linguistic Discontinuity in a Northern Athapascan Community." *Journal of Linguistic Anthropology*, 17:1, 23-43.
- Milroy, James. 2001. Language ideologies and the consequences of standardization. *Journal of Sociolinguistics*, 4:5, 530-55.
- Moosmüller, Sylvia dhe Teodor Granser. 2006. "The Spread of Standard Albanian: An illustration based on the analysis of vowels". *Language Variation and Change*, 18, 121-140.
- Morgan, Carrie Ann. 2017. "Post-socialist language ideologies in action: Linking interview context and language ideology through stance." *Journal of Sociolinguistics*, 21:1, 34-63.
- Munishi, Shkumbin. 2013. *Probleme të shqipes standard në Kosovë*. Prishtinë: Zero Print.
- Qendra e Studimeve Albanologjike [QSA]. 2011. *Shqipja në Etapën e Sotme: Politikat e Përmirësimit dhe të Pasurimit të Standardit*. Tiranë: Botimet Albanologjike.
- Sankoff, Gillian. 2006. "Age: Apparent time and real time". Në *Encyclopedia of Language and Linguistics*, botimi i dytë. Elvise: Cambridge.
- Silverstein, Michael. 1985. Language and the Culture of Gender: At the Intersection of Structure, Usage, and Ideology. In Elizabeth Mertz, Richard Parmentier (Eds.) *Semiotic Mediation: Sociocultural and*

- Psychological Perspectives. Orlando, FL: Academic Press Inc.
- Skendi, Stavro. 1967. *The Albanian National Awakening: 1878-1912*. Princeton: Princeton University.
- Suslak, Daniel F. 2009. "The sociolinguistic problem of generations." *Language and Communication*, 29, 199-209.
- Vehbiu, Ardian. 1997. Standard Albanian and the Geg Renaissance: A Sociolinguistic Perspective. *The International Journal of Albanian Studies*, 1:1, 5-20.

Përgatiti Carrie Ann Morgan